

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Komisioni Evropian propozon kufizimin e të drejtave për anëtarët e ardhshëm të BE-së
ADRESA	https://dosja.al/politike/komisioni-evropian-propozon-kufizimin-e-te-drejtave-per-anetar-et-e-ardh-i516636
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 07:58:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 07:47:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7ee3759688354338f9e038915493c801d0f35f40f9e0e5f6e59d861a8f81cd6d
TEKSTI	fb70a6815b34a6325cd66365ab43dcf699f87cdfb198c07eae58a70653996159
PAMJA	3c1e7533072038c39e31f9d053dedf25702ed911bcd5f18f21622f713b71c744

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	094e4751c41a7f794ac0ae7bbe4ccb3599d68b69ba2f2b210f203085d0dbf1e7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/094e4751c41a7f794ac0ae7bbe4ccb3599d68b69ba2f2b210f203085d0dbf1e7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 ORE ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit mesazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

14 ORE ME PARE

Debate për territorialen te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

19 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

22 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
ballë, do jetë dështim

Politike

Komisioni Evropian propozon kufizimin e të drejtave për anëtarët e ardhshëm të BE-së

Këto janë elementet kryesore të strategjisë për zgjerimin që KE-ja do ta miratojë dhe publikojë më 7 tetor. Qëllimi i këtyre dy propozimeve është që pranimi i anëtarëve të rinj të mos e vështirësojë edhe më tej procesin tashmë të komplikuar të vendimmarrjes brenda bllokut evropian.



29 Shtator 2026, 09:47
Nga E. D



foto ilustruese

BRUKSEL- Komisioni Evropian do të propozojë kufizimin e disa të drejtave për anëtarët e ardhshëm të Bashkimit Evropian (BE), si dhe kalimin në vendimarrje me shumicë të kualifikuar, në vend të unanimitetit, në një numër fushash, përfshirë edhe zgjerimin.

Këto janë elementet kryesore të strategjisë për zgjerimin që KE-ja do ta miratojë dhe publikojë më 7 tetor. Qëllimi i këtyre dy propozimeve është që pranimi i anëtarëve të rinj të mos e vështirësojë edhe më tej procesin tashmë të komplikuar të vendimmarrjes brenda bllokut evropian.

KE-ja në strategji do të theksojë se zgjerimi duhet të përgatitet mirë, për përfitim të ndërsjellë. Nga njëra anë, kandidatët për anëtarësim duhet të jenë të gatshëm dhe të përbushin kushte të repta, ndërsa nga ana tjetër, edhe BE-ja duhet të jetë institucionalisht, financiarisht dhe politikisht e gatshme që të mbetet funksionale edhe pas zgjerimit.

Sipas draftit të dokumentit, në të cilin ka pasur qasje Radio Evropa e Lirë (REL), mekanizmat për anëtarët e ardhshëm, që po përgatit Komisioni, do të synonin kufizimin e mundësisë për bllokimin e vendimeve gjatë viteve të para të anëtarësimit, ndërsa shtetet anëtare ekzistuese do të kishin në dispozicion instrumente për të reaguuar nëse anëtarët e reja, pas anëtarësimit, devijojnë nga detyrimet e marra përsipër.

Anëtarët e ardhshëm pa të drejtë vetoje

Elementi më i ndjeshëm i draftit ka të bëjë me kufizimin e së drejtës së vetos, që në dokument quhet në mënyrë simbolike "detyrim i përkohshëm lidhur me vendimmarrjen në Këshillin e BE-së dhe Këshillin Evropian". Sipas këtij

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

BOTA 29 SHTATOR 2026, 09:50

Në ditët e fundit të afatit, ish-marinasi amerikan kërkon vëllanë në një kamp refugjatësh afganë në Katar

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:51

Eksperti i sigurisë kibernetike: Hakerat e "Homeland Justice" publikojnë numrat e agjentëve të SHISH

propozimi, anëtarët e ardhshëm do të zotoheshin të mos kundërshtonin vendimet e Këshillit në fushat në të cilat kërkohet unanimitet.

Ky propozim do të zbatohet për çështjet institucionale dhe çështjet që lidhen me zgjerimet e ardhshme. Në këmbim, siç thuhet në draft, institucionet evropiane do të angazhoheshin për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme kur një anëtar i ri t'i referohej interesave thelbësore kombëtare.

Marrëveshjet e reja, sipas burimeve të REL-it të njohura me përmbajtjen e dokumentit, do të përfshiheshin në një deklaratë të përbashkët që do t'i bashkëngjitej Traktatit të Anëtarësimit. Deklarata do të miratohej para Traktatit të Anëtarësimit.

Klauzolat mbrojtëse

Përveç mekanizmave ekzistues që kanë vlejtur për anëtarët e mëparshme, KE-ja do të propozojë shtimin e dy mekanizmave të rinj, që lidhen me çështjet financiare dhe institucionale.

Mekanizmi financiar mbrojtës do t'i mundësonte KE-së që, për një periudhë të kufizuar pas anëtarësimit, të propozojë masa proporcionale nëse ka prova të qarta ose rrezik serioz se mangësitë në sundimin e ligjit po rrezikojnë menaxhimin financiar të buxhetit të BE-së ose mbrojtjen e interesave të tij financiare.

Klauzola institucionale do të zbatohet në rast të një "shkeljeje veçanërisht të rëndë", kur Këshilli i BE-së do të mund të miratonte masa të përshtatshme dhe proporcionale, përfshirë pezullimin e përkohshëm të disa të drejtave që rrjedhin nga anëtarësimi.

Komisioni, përmes këtij dokumenti, do të paralajmërojë gjithashtu forcimin e masave në rast të përkeqësimit të sundimit të ligjit, demokracisë dhe të drejtave themelore pas përfundimit të negociatave të anëtarësimit.

Ndryshime të propozuara edhe në institucionet e BE-së

Duket se anëtarësimi në BE nuk do të nënkuptojë që anëtarët e ardhshme do të kenë automatikisht edhe komisionarët e tyre, pasi sipas propozimit të ri kjo nuk do të vlejë as për anëtarët ekzistues.

Komisioni, në fakt, propozon që numri i komisionarëve, i cili aktualisht korrespondon me numrin e shteteve anëtare, të reduktohet në dy të tretat e numrit të shteteve anëtare, me rotacion rreptësisht të barabartë.

Komisioni mbështet gjithashtu zbatimin më të gjerë të votimit me shumicë të cilësuar, si dhe bashkëpunimin e shtuar të një grupi shtetesh kur nuk ka unanimitet.

Drafti, ndër të tjera, propozon që vendimarrja me shumicë të cilësuar të zbatohet në hapat ndërmjetës të procesit të zgjerimit, siç janë hapja dhe mbyllja e kapitujve, ndërsa unanimiteti do të vrente vetëm për vendimin përfundimtar për pranimin e një anëtareje të ardhshme në BE./REL

komisioni evropian

Sondazh

Poll

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:41

VIDEO/ Personi më i moshuar i botës banon në Shqipëri, nënë Marra ka lindur 117 vjet e 39 ditë më parë

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidate

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow

Politike

29 Shtator 2026, 09:22

Nga inovacioni te turizmi i qëndrueshëm/ Rama sot në Bruksel në Samitin e Euronews 2026 për Turizmin

Edi Rama BRUKSEL- Kryeministri Edi Rama do të jetë sot në Bruksel, ku do të marrë pjesë në Samitin e Euronews p&eu...

Analiza e DW: A do të ndryshohet ligji për Gjykatën Speciale?

Politike

28 Shtator 2026, 22:52

"Auditim në SHISH pas arrestit të Vlora Hysenit"/ Zbardhen diskutimet në Këshillin e Sigurisë. Çfarë thanë kreu i SPAK dhe Kryeministri Rama

Politike

28 Shtator 2026, 20:14



Reforma territoriale/ Emiriona Sako: Kompetencat e centralizuara të rishikohen dhe të kthehen te bashkia, çdo funksion duhet shoqëruar me kompetenca të qarta

Politike

28 Shtator 2026, 19:10

Agron Shehaj në Konferencën Ndërparlamentare me BE: Ju dhe SHBA investuat te drejtësia, Rama i ka shpallur luftë! E sulmon përditë

Politike

28 Shtator 2026, 18:54

Politike

28 Shtator 2026, 18:29

"A-ia e gjithckaie është afërsia me avtëtarin"/ Fisnik

Qosja në Komisionin e Ligjeve: Kërkojmë vlerësim publik të reformës së kaluar para se të merret vendimi përfundimtar

Fisnik Qosja TIRANA- Fisnik Qosja, kryetari i Bashkisë së Kavajës ka marrë fjalën në Komisionin e Ligjeve ku ka mbështetë...

FOTOLAJM/ Elvis Lila u shfaq për herë të parë në publik, kush është drejtuesi i ri i SHISH i komanduar nga Rama

Politike

28 Shtator 2026, 17:51



Debate te "Ligjet" për territorialen/ Brahimi: Bashkimi i bashkive ul kostot me mbi 30%. Korreshi: Ky po tall by***n, po e bëni për të grumbulluar votat e PS

Politike

28 Shtator 2026, 17:34

Rama takim me drejtuesit politikë në qarqe te "Vila e Kuqe"/ Në fokus "Prania besnike" dhe takimet me qytetarët

Politike

28 Shtator 2026, 16:41

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet candidate

Politike

28 Shtator 2026, 15:42

MË SHUMË



Emiriona Sako: Kompetencat e centralizuara të



Emiriona Sako:
Kompetencat e centralizuara të rishikohen dhe të kthehen te bashkia

Debate te "Ligjet"/ Korreshi:
Ky po tall by***n, po e bëni për të grumbulluar votat e PS

Me flakadanë në duar,
protestuesit marshojnë nëpër rrugët e Tiranës, thirrje njëzëri kundër qeverisë

Dita e 121-të e protestës,
qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni